



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Menaxhimi i riskut bankar

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i riskut bankar
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I (semestri I)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda shtjellon rreziqet e sektorit financiar, me fokus të veçantë rreziqet e sektorit bankar. Brenda lëndës trajtohen llojet kryesore të rreziqeve më të cilat përballen bankat, si rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional, rreziku i normave të interesit dhe rreziqet e tregut. Gjithashtu lënda jep zgjidhje edhe për menaxhimin e këtyre rreziqeve.
Qëllimet e lëndës:	Menaxherët bankar në një funksion rreziku në banka duhet të kuptojnë natyrën dhe burimet e rreziqeve të cilave u nënshtrohen depozituesit, mbajtësit e kapitalit dhe mbajtësit e borxhit. Qëllimi i këtij kursi është t'i japë studentit një njohuri të detajuar për natyrën e këtyre rreziqeve, mënyrën e matjes së ekspozimit që një bankë ka ndaj rreziqeve të tilla dhe një kuptim të disa mënyrave në të cilat rreziqe të tilla mund të menaxhohen nga një bankë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin me sukses të këtij kursi, studenti duhet të jenë në gjendje të: - vlerëson rreziqet ndaj të cilave bankat janë të ekspozuara; - kupton teorinë dhe praktikën e menaxhimit të rrezikut brenda bankave dhe në nivel sektori, duke mbuluar kategoritë kryesore të rrezikut (përfshirë riskun kreditor, të tregut, operacional, likuiditetit,

	normave të interesit, kembimit valutor, legal, etj; - identifikon instrumentet e ndryshme të vlerësimit dhe kontrollit të risqeve; - vlerëson kornizat rregullatore kombëtare dhe globale të nderlidhura me risqet në sektorin bankar, etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Teste, detyra të shtëpisë	2	10	20
Seminare, projekte kërkimore, prezentimet,etj.	5	5	25
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	5	15
Përgaditja përfundimtare për provim	5	6	30
Totali			180/30 = 6ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point; • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime; • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar.		
Metodat e vlerësimit:	- Pjesëmarrja dhe aktiviteti në ligjerata.....0 – 10% - Test i ndërmjetëm.....0 – 10% - Projekti hulumtues.....0 – 30% - Provimi final.....0 – 50%		

Literatura	
Literatura bazë:	1. Joel Bessis, Risk management in banking, Fourth edition, Wiley, 2015; 2. John Hull, Risk Management and Financial Institutions, 4th ed., Wiley Finance, 2015.
Literatura shtesë:	1. Maura La Torre, Risk in Banking Developing a Knowledge Risk Management Framework for Cooperative Credit Banks, Palgrave macmillan, 2020.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Rreziqet dhe Menaxhimi i Riskut
Java e dytë:	Përmbledhje e rregulloreve bankare
Java e tretë:	Menaxhimi i Bilancit dhe Rregulloret
Java e katërt:	Menaxhimi i likuiditetit dhe boshllëqet e likuiditetit
Java e pestë:	Boshllëqe në normat e interesit, Rreziku i normave të interesit
Java e gjashtë:	Rreziku operacional
Java e shtatë:	Rreziku i tregut, rregulloret për rrezikun e tregut
Java e tetë:	Rreziku kreditor
Java e nëntë:	Rreziku i kredisë nga palët
Java e dhjetë:	Rreziku i portofolit të kredisë: Analizë
Java e njëmbëdhjetë:	Rregulloret për rrezikun e kredisë
Java e dymbëdhjetë :	Shpërndarja e kapitalit dhe kontributet e rrezikut
Java e trembëdhjetë:	Tre shtyllat e Bazelit II
Java e katërbëdhjetë:	Hyrje në kërkesat e Bazel III
Java e pesëmbëdhjetë:	Rëndësia dhe objektivat e rregulloreve për banka

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së. • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në

orën mësimore;

- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.